



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-27037/22 datë: 21.08.2022



Npi – 01/297 datë: 26.09.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 26.09.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S S Ë - V I - T Ë K O M I T E T I T P Ë R K O M U N I T E T E
E mbajtur më: 26.09.2022 (e hënë) në ora 14:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë Kryesuesi i KPK-së z.Bajram Ilazi, anëtarët e Komitetit për Komunitete: z.Besnik Seferi, znj.Shkurte Mustafa, znj.Rrezartë Ramadani, z.Muhamet Mehmeti, z.Arton Demiri. Në mbledhje përveq anëtarëve të Komitetit kanë marrë pjesë edhe: z.Ibrahim Demiri përgjegjës i ZKKK-së, z.Shqiprim Hyseni, - Praktikant në Kuvend dhe znj.Adelina Baliu – Praktikante në ZKKK-ë.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK-se me 30.08.2022,
2. Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së,
3. Diskutim për Planin Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik),
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.

z.Besnik Seferi; Përshëndetje, pajtohem plotësisht me rendin e ditës, por propozoj që planit buxhetor 2023-2025, me i dhënë një fokus më të gjerë.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi rendin e ditës.**

Pika 1

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Mendojë që komplet fjalimet e mi ja kanë qenë të përfshira në procesverbal. Shfrytëzoj rastin me i përgëzuar për një punë të mirë, sekretarin e Kuvendit për përpilimin me shkrim të procesverbaleve.

***Komiteti për Komunitete, unanimitisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin, nga mbledhja e KPK-së e mbajtur më 30.08.2022.**

Pika 2

Informatë për aktivitetet mujore të ZKKK-së

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Fjalën për prezantimin e kësaj pike ja dha Ibrahim Demirit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Kthimi: Kërkesa për kthimin e personave të zhvendosur nuk ka pasur. Riatdhesimi: Më 23 shtator, një familje e komunitetit ashkali, ka kërkuar ndihmë nga ZKKK-ja, pas kthimit nga Suedia. Kryefamiljari është z.Gazmend Jakupi, me bashkëshorten znj.Nadie Jakupi (1979) dhe 4 fëmijët, vajzat: Medina (2003), Azize (2005), djemtë: Medin (2008) dhe Enes (2022) Jakupi. Po ashtu Emine Maliqi, komuniteti ashkali, e lindur më 23.08.1989, është e riatdhesuar nga Gjermania me 25.06.2021 me tre fëmijët: Amir Maliqi 2009 (Prishtinë), Adile Maliqi 2012 (Prishtinë) dhe Amira Maliqi 2015 (Bon-Gjermani). Gjatë vlerësimit dhe pas strehimit me qira nga MPB për një vit, kërkesën e kemi transferuar në DSHMS-ë që t'i vazhdohet qiraja deri në zgjidhjen e problemit të strehimit, sipas kontratës me qiradhënësin. Kjo familje kishte të siguruar qiranë për banim deri në fund të muajit qershor, nga MPB-Departamenti për Riatdhesim kurse pas muajit Qershor është obligim që Komuna të gjejë zgjidhje të banimit për këtë familje, sipas Rregullores 22/2020 për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar. Ministria për Financa e Punës dhe Transfereve (MFPT) Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (APRK) në bashkëpunim me Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP) mbështetur nga Ministria e Punëve të Brendshme (MPB) Departamenti për Ri integrimin e Personave të Riatdhesuar (DRPR), shpallin thirrjen e tretë të hapur për personat e riatdhesuar për dorëzimin e aplikacioneve për hapjen e bizneseve me mbështetje me mjete/pajisje teknike në kuadër të Programit të Vetëpunësimit. Kemi përgatitur listën e të riatdhesuarve që mund të aplikojnë në këtë Program dhe i kemi njoftuar ata. Aktivitetet për Integrimin e Komuniteteve RAE sipas Planit Lokal të Veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në Komunën e Shtimes. Në kuadër të Projektit “Përfshirja Sociale dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian dhe grupe të tjera të cenueshme në Kosovë”, ka vazhduar bashkëpunimi me OJQ “VORAE”. Kjo Organizatë është e involvuar në procesin e përfitimit të bursave për nxënës të shkollës së mesme, por problemi ka lindur pasi që këtë vit nxënësit duhet të aplikojnë On-line për bursa që ka paraqitur problem në futjen e të dhënave në sistemin elektronik, ku duhet të ngarkohen të gjitha dokumentet e nevojshme për aplikim e që është e pamundur të zbatohet kjo formë e aplikimit, nga nxënësit, po edhe nga ZKKK-ja dhe OJQ-të. Projektet në terren për komunitetet dhe përfituesit si dhe bashkëpunimi me palët e interesit. Në bashkëpunim me IOM-in kanë nënshkruar kontratat 4 aplikues për përkrahje të bizneseve të reja familjare: Florie Brahimi-Shtime, Shkurte Baftiu-Shtime-Frizere, Lumturie Maliqi-Shtime, dhe Nixhare Kadria-Gjyrkovc. Nga bashkëpunimi me IOM-in gjithashtu kemi marrë konfirmimin, pas nënshkrimit të Letër-mbështetjes nga ana e Kryetarit z. Qemajl Aliu, se është aprovuar dhe do të realizohet edhe Projekti “Kabineti shkencor i Shkollës”, në fshatin Gjyrkovc, i cili do të financohet nga IOM-i me shumën 11,000€ kurse Komuna do të participojë me shumën 4,500€ Projekti realizohet në kuadër të Programit EU për Stabilizimin e Komuniteteve IV (EU CSP IV). Jemi në pritje të realizimit të këtij projekti. Gjithashtu te KFOR-i TURK, ne në bashkëpunim me Qendrën për Mësim-nxënie në Shtime, kemi bërë kërkesë për çanta dhe pajisje shkollore për 75 nxënës, duke i bashkangjitur Listën e fëmijëve të klasave I-V. Çështje të tjera ose aktivitete: Nga Zyra e Kryeministrit për Çështje të Komuniteteve vazhdon të mbajë punën praktike me pagesë në Shtëpinë e Kulturës, studenti Erxhan Mehmeti (komuniteti ashkali), për gjashtë muaj. Nga data 19 shtator kemi pranuar në ZKKK një praktikante, e cila do të punojë në monitorim të OJQ “Voice of Roma, Ashkali and Egyptians” (“VORAE”), me pagesë, të cilën e ka përzgjedhur kjo OJQ. Me organizatën “Help”, kanë përfituar projekte në vlerë 2000€ këta aplikantë: Hasan Qerimi-saldues, Zenel Jakupi-saldues, Xhemaj Jakupi-autolarje, Behlul Kadrija-ndërtimtari, Nexhat Sadriu – Bujqesi. Kemi hartuar listën prioritare për

ndërtim dhe riparim të shtëpive. Për ndërtim kanë nevojë urgjente këto familje: Baki Jakupi-Shtime, Lulzim Rama-Gjyrvoc, Urim Shabani-Shtime, mbindërtim, Muhib Bajrami-Gjyrvoc, Jeton Maliqi-Shtime (i riatdhesuar), Shashivar Tahiri-Gjyrvoc, Besnik Mehmeti-Shtime (i kthyer nga rajoni). Lista prioritare për riparim të shtëpive: Elmi Shabani-Shtime-Shtime (MPMS), Arben Osmani-Shtime (MPMS), Mexhit Rama-Gjyrvoc, Bexhet Bajrush-Shtime, Shaban Ilazi-Gjyrvoc, Zekë Demiri-Shtime (MPMS), Shkelzen Osmani-Shtime (MPMS), Ramiz Kadriu-Gjyrvoc (MPMS), Basri Maliqi-Shtime (MPMS), Rrahim Maliqi-Shtime, Hasret Durmishi-Shtime. Në këtë listë janë 6 familje, të cilave MPMS-ja u ka ndërtuar shtëpitë, por që kanë mbetur të papërfunduara dhe që ende nuk janë për banim. Lidhur me këtë problem, Kryetari i Komunës z.Qemajl Aliu ka pritur në takim zv.Ministrin e Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, z.Resul Makreshi, ku është propozuar edhe zgjidhja për përfundimin e këtyre shtëpive duke ndihmuar drejtpërdrejtë përfituesit me mbikëqyrje të një komisioni që do të formohet nga Komuna dhe Ministria. Ende nuk kemi ndonjë informatë për këtë dhe jemi në pritje të zgjidhjes së këtij problemi. Në Ministrinë për Komunitete dhe Kthim, nga lista prioritare, kemi dorëzuar 10 kërkesa, 3 për ndërtim dhe 7 për riparim.

Buxheti: ZKKK-ja ka buxhetin prej 6500€ dhe është në pritje të realizimit të kërkesave. Kemi bërë shpalljen publike për OJQ-të që të aplikojnë për subvencione dhe kemi pranuar kërkesën e OJQ-së me vlerë 2000 euro për aktivitete me të rinjtë e komunitetit Ashkali dhe Rom. Faza e parë 8 kërkesa: Shëndetësi (gjashtë) 6 kërkesa shuma 1033.6 €, Renovim, (një) 1 kërkesë, shuma 440.45 €, Qera për banim, (një) 1 kërkesë, shuma 300 €, Gjithësej 1768.65 €. Në fazën e dytë kemi pranuar kërkesat: Shëndetësi, (dy) 2 kërkesa, shuma 693.04€, Për manifestimin e festës së komunitetit rom 8 Prillit, shuma 199.50€, Për aktivitete të programit veror për nxënësit e komunitetit Ashkali dhe Rom, klasat I-VI, 490€, Për përkrahje sociale, mbulim të shpenzimeve për pajisjen me një mjet pune, 200€, OJQ “ASU”, 2000€ për projektin sipas Shpalljes publike për subvencione nga ZKKK, Gjithësej 3582.54 Këto kërkesa ende nuk janë aprovuar nga Komisioni për ndarjen e subvencioneve. Komisioni nuk i ka shqyrtuar ende ato për shkak se ka probleme të mbajë mbledhjet e thirrura. Megjithatë ZKKK i ka kompletuar ato dhe presim të realizohen shumë shpejt. Pas aprovimit të kërkesave të përcjell ura në Komisionin për Subvencione, ZKKK do të shpenzojë buxhetin prej 5351.19€ që do të thotë se ka në dispozicion edhe 1449€ për kërkesat eventuale. Buxheti i subvencioneve për ZKKK-në, nga viti 2023 do të jetë 8000€, nga 6500 sa ka qenë. Me datën 23 të këtij muaji na ka ardhur një familje nga Suedia pas qëndrimit 17 vjeçar familja Gazmend Jakupi. E kemi alarmuar këtë rast të enjten kemi me vizituar, nuk kanë strehim, e kemi obligim me strehuar.

znj.Rrezartë Ramadani; Gjatë qëndrimit atje 17 vite a kanë ardhur ndonjë herë në Kosovë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Jo.

znj.Shkurte Msutafa; Çfarë Nacionaliteti kanë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Janë ashkali. E kemi rregulloren 20/2022 që e përcakton kush ka drejt me përfituar, është detyrë e jona. E kam dorëzuar listën e të riatdhesuarve në bazë të planit të biznesit, nuk kemi raste të tilla, sepse gjitha i kam përcjellë si raste. Sa i përket planit të veprimit i ka dal afati, jemi në pritje të aprovimit me një OJQ, duhet ta adaptojmë me Strategjinë Kombëtare për Komunitete, e cila është vonuar, tani më është bërë së fundmi nga Qeveria. Kemi vazhduar me OJQ-të, bashkëpunim i mirë ka qenë me “VORAE”. Burasat për fëmijë, aplikacionet i kemi këtu për shkak se Ministria ka kërkuar që on-line të bëhet aplikimi. Kam me kërkuar nëpërmjet një shkrese që edhe këtë vit të pranohet aplikimi fizik. Edhe këtë vit në Ministri janë nënshkruar 4 kontratat për sera, këto janë biznese familjare që kanë pranuar me participim. Me IOM-in jemi tu prit me realizuar projektin “kabineti i gjuhëve” në Gjyrvoc, këtu lokali ende nuk është i gatshëm, mungon uji, si Komunë kemi ndarë 4500 euro kurse IOM-i 7000 euro. Si çdo herë që na ndihmon KFOR-i Turk, kemi bërë kërkesën për qanta ata kanë nda një numër 75 pako. E kemi edhe një praktikante në zyrën tonë përmes “VORAE” mundemi edhe një

por kontrata është vetëm 3 muaj. Me “HELP Kosova” kanë përfituar disa si saldues kryesisht. Për ndërtim të shtëpive i kemi 7 raste, kurse për riparim të shtëpive i kemi 11 raste.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Te pika të ndryshme kam planifikuar me e fut si rekomandim. plotësimin e zyrës së ZKKK-së.

z.Arton Demiri; Përshëndetje, a kemi mundësi që 15 prillin që është dita flamurit me mbuluar me buxhet.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; E kemi planifikuar në plan buxhet, janë 200 euro për mbulimin e kësaj dite, por buxheti fillon në muajin shkurt, pastaj 15 shkurti dita flamurit, po na kalon tani prilli.

z.Besnik Seferi; Faleminderit për informatën, sa i përket bursave, për nxënësit po më pëlqen, por te lista e ndërtimit të shtëpive një emër, Sherif Jashari nuk po e shoh. Planin na e kemi bërë një kërkesë që të vazhdojmë me planin e veprimtimit pse nuk ka ndodh a kanë shkuar këto kërkesa me kohë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Riatdhesimi është një detyrë e jona, për rastet e cenueshme, projektet të gjitha duhet të drejtohen te zyra e punësimit, ta shfrytëzojnë skemën e vetëpunësimit. Bursat gjithë nxënësit të komuniteteve përfitojnë bursa, dy vitet e fundit kanë përfituar. Te banimi te rasti Sherif Jasharit e kemi lënë pak anash. Është rast që nuk ka vend ku ti ndërtohet shtëpia, për qira është problem sepse ky është nga një Komunë tjetër. Te serat 4 kanë përfituar, lista për aplikim që tri vjet është te IOM-i na 9 i kemi rekomanduar ata kanë zgjedh 4.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Këta që janë përzgjedh, mos po përfitojnë disa nga tri herë e dikujt tjetër nuk i epet mundësia e përfitimit asnjë herë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Jo nuk ka pasur raste të tilla.

z.Muhamet Mehmeti; 51 aplikime kanë qenë IOM-i i ka marr të gjitha i ka nda me faza në mesin e këtyre ne kemi rekomanduar 9 ata kanë përzgjedh tani, e nuk ka pasur favorizime.

Komiteti për Komunitete ofron mbështetje në iniciativën e ZKKK-së për ndryshimin e aplikimit për bursa për nxënësit e Komunitetit drejtuar MASHT-it, që nxënësit të aplikojnë edhe këtë vit fizikisht, arsyeja që një pjesë e konsoliduar e nxënësve nuk mund të aplikojnë nëpërmjet sistemit E-Kosova.

Pika 3

Diskutim për Planin Buxhetor Komunal për periudhën 2023-2025, (pas diskutimit publik)

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Sa i përket buxhetit është 17282, këtu është një e metë që nuk është planifikuar buxhet për punëtor në zyrën tonë të ZKKK-së që duhet me qenë 3 persona. Me këtë buxhet mendoj se i mbulojmë prioritetet.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Sa kishit pas mundësi ju si zyre me vendos për ndërtim të shtëpive?

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Për këtë aspekt, ndërtimin e shtëpive duhet me qenë një vijë e veçante e buxhetit nuk lejon ndryshe Ministria, mirë do të ishte me qenë kjo vijë e veçante por nuk është.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Disa prej kërkesave të mija apo Rekomandimeve që kemi bërë si Komitet janë marr parasysh, mungon planifikimi buxhetor për dy Qendrat Mësimore në fshatin Gjurovc dhe Vojnovc.

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit, që në buxhetin e vitit 2023 të planifikojë kompletimin e stafit të zyrës së ZKKK-së, sipas rregullores 02/2010 për Zyrtarët Komunal.**

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i Rekomandoj Kuvendit, që në buxhetin e vitit 2023 të planifikojë një fond të veçante për ndërtim dhe renovim të shtëpive të Komunitetit pakicë, dhe jo vetëm të komunitetit, deri në ndërtimin e një objekti për banim Kolektiv.**

***Komiteti për Komunitete, unanimisht vendosi t'i rekomandojë Kuvendit që në buxhetin e vitit 2023 të planifikojë buxhet për stafin e dy Qendrave Mësimore, për mësim shtesë për nxënësit e komunitetit ashkali në fshatrat Gjyrkovc dhe Vojnovc, duke marrë parasysh marrëveshjen me OJQ-në "VORAE" e cila ka bashkë-financuar me Komunën e Shtimes, disa projekte, duke përfshi edhe këto dy Qendra.**

***Komiteti për Komunitete, unanimisht miratoi konkluzionin që rekomandimet e sotme të KPK-së, më 26.09.2022, t'i prezantojnë anëtarët e KPK-së të cilët njëkohësisht janë edhe anëtarë të Kuvendit, nesër në mbledhjen e Kuvendit më 27.09.2022.**

Pika 6

Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 15:31h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi